

12  
juzhe Sfe

R r u s a r i i  
i  
Z o n j e s V i r g j e r e  
e S h e n M e r i

R r u s a r i i  
i Zonjes Virgjere e  
S h e n M e r i  
M e m a e t'in'Zoti

Botoi "MONDO ALBANESE" 1983  
te Sklitsa e Horës s't'Arbëreshëvet

Rrusarii i Shën Mëris

----

Nd'ëmbërër t'Jatit,të Birit,të Shpirtit  
Shejt. Ashtu' kloft.

Paçe lipisì për mua , o i Madh'in'Zot  
U ndienj pendim, o i Larti Perëndi,  
dhëmbem e helmonem me gjithë zëmbërë  
për gjithë mëkatët që kam bër te gje-  
lla jime.

Helmonem se kam sbiërrë Parraisin e  
më nget pisa; po më shumë më dhëmp  
zëmbra , se , tue mëkatruar , kam  
ftesur Tij, i madh'in'Zot,që je gjithë  
E MIRA e që ka ' dua mirë mbi gjithë  
shërbiset.

U të taks me të vërtetë,me ndihmën  
t'ënde, të mos të ftes më me mëkatën  
t'ime. Vdeksha më mirë ! Po Të daf-  
sha mirë e të shërbesha Tij,i Madh'in  
Zot e klofsha me Tij për gjithë monë.

O Zonja Virgjërë e shën Mëri,dua sot  
të thom rrusariin shejt,e të truhem  
fort mos më lipset kurr lipisia e  
t'in'Zoti.

Ati i jinë që je në kjiell, shejtëruar  
kloft émbri i jit , arthët rregjéria  
e jote , u bëft vullimi i jit , si në  
kjiell ashtu' në dhe.

Bukën t'ënë të përditçmen ëna neve sot ,  
ndëjéna dëtirët t'ona , ashtu' si edhe  
na ja ndëjéjëm dëtëruamëvet t'anë , e  
mos na le të biem në ngarie, po lirona  
nga i ligu . Ashtu' kloft.

Falem , Mëri , e Hir-plota , in'Zot  
ë me Tij .

Bekuarë Ti je mbi gjithë grat , e  
bekuarë pema e gjirit t'ënt I s u t h i .

E shë Mëri , Mëma e t'in'Zoti ,  
parkalés për ne të mëkatruamitë , nanì  
e te hera e vdekjies t'ënë . Ashtu' kloft!

Lëvdì past Ati , Biri , Shpirti i  
Shejt nanì edhe për gjithë monë .

Ashtu' kloft.

M i s t e r e t t ë g ë z i m e v

1. Nga Parraisi një i dërguar  
pruri fialën për të rruar  
e kur uji kriet Mëria  
te Ajò zuri Perëndia .

Zonja e madhe kam haré  
përsé Ti e gëzuame je.

*Edhé na klofshim me zëmbren  
të përunjët, tue haristisur Pe-  
rëndin , se ndë jetë na dërgvi  
të Birin e 'Tij të vetëmin, që  
njeri u bë për ne.*



2. Vaté pran te Lisabeta  
Zonja Virgjërë , e te jeta  
ng'ishë shën Janji,po u gëzua  
e te gjiri u shejtërua .

☩ Zonja e madhe kam haré  
përsé Ti e gëzuame je .

*Dafshim vëllauthin t'ënë si vetë-  
hën. Arthëshit shën Mëria edhe ndër  
ne e na gëzoft z^embrën .*





3. Mbi tsa kashtë e te një shpel  
kur ishë nata shum' e thellë  
u le Diali i Krietarit  
ndërmës kaut edhe gomarit

Zonj ' e madhe kam haré ,  
përsé Ti e gëzuame je .

*Arthëshit Zoti Krisht te zëm -  
brat t'ona, mos t'i kemi lidhur  
me jetën që ka ' lëm për gji-  
thë monë.*



4. Si gjith't'jerazit fajto  
Virgjëresha ndë faltore  
me të përunjur mori e shkoi  
e t'in'Zoti ja dhuroi .

Zonja e madhe, kam haré ,  
përsé Ti e gëzuame je .

*Klofshim të dëlirë te kurmi  
e te mendia. Ruashim Ligjën  
e t'in'Zoti e të Klisë së  
shejte.*



5. Kur i Larti Bir u sbuar  
vej Shë Mbriza tue kërkuar;  
mbi tri ditë te kjiteti  
ndër të diturit e gjeti .

Zonj'e madhe kam haré  
përsé Ti e gëzuame je.

*Mos t'e sbieriëm kurr t'ënë  
Zonë; t'e kërkofshim me dishi-  
rëm, sa t'na japënjë dritë të  
rrvojëm drekj.*



# M i s t e r e t e h e l m ë v e t

1. Brënda kopshtit parkales  
i pa-vdekti e ndien se vdes;  
psherëtën tue dirsur gjak,  
sa me atë gjithë trolli u  
l a k .

O e helmuara e shë Mëri  
bashkë me Tij u jam ndë zi.

*Po u dhëmpshim për mëkatët  
t'ona e ndë helme me zëmërë po  
të të thomi: u bëft vullimi i  
jit, o i Madh'in'Zot!*






2. Si një kjenkjëth e rrëmbien  
e pështijtín e shkarzien;  
me shkupinj e vran e e sosën,  
gjith ' e murrën e e lavosën .

O e helmuara e shë Mëri,  
bashkë me Tij u jam ndë zi .

*Mundëshim tërbimet e kurmit  
çë si suvala na trazojën shpir-  
tin të biem te mëkata, e paçim  
durim te helmet.*



3. Mbret i falur për të kjesur  
me një tsopë t'kukje i veshur  
i vun glëmbash një kurorë  
e për shkop një kallëm në dozë .

helmuara e shë Mëri,  
me Tij jam ndë si.

*Vufshim edhe na një kurorë glëm-  
bash, sa t'jikiëm mendimeshit të  
kekjë e mos t'biem te mëkata.  
Klofshim të përunjët me gjithë  
njeri.*



4. E gjikuan si një kusar  
si një vrasës për të vrar;  
kush e nëm e kush e rrah,  
kush e shan me krikjen n'krahë.

O e helmuara e shë Mëri ,  
bashkë me Tij u jam ndë zi .


*Marrshim me pakje krikjien  
çë in'Zot na jep e u vufshim te  
dhromi çë Ai na dëftoi.*



5. Te ajo krikje e mjera e jëmë,  
si e kjëlluarë nga një gjëmë,  
të varruar me mishtë shkjerrë,  
sheh të birëthin të vjerrë.

O e helmuara e shë Mëri ,  
bashkë me Tij u jam ndë zi.

*Mbafshim n'mend sa shkoi te  
jeta in'Zot, e sa duroi Shë  
Mëria; marrshim me të mirë gji-  
thë helmet e kësaj jetie e shkretë.*





M i s t e r e t t ë l ë v d i v e t

1. Si një trim ç'u sgjua nga gjumi  
mbi tri ditë u ngjall i Lumi.

Vate e prindrat liroi,  
e nga i ligu na shpëtoi.

~~Shë Mëri~~ e lume e shë Mëri  
~~shë Mëri~~ me Tij u bënë haidhi.

*U ngjallshiti shpirti i jinë  
me skomollin, e mos u varrof-  
shim më te mëkata që ka 'jikiëm  
tue thritur shë Mërin.*



2. Mundësor , mbi dizetë ditë,  
te Parraisi Krishti u ngjip,  
i pritur mel lëvdi ,  
me këndime e me haidhi.

Zonja e lume e shë Mëri,  
bashkë me Tij u bënj haidhi.

*Ma dhëfshit in'Zot dishirimin  
t'e duam mirë me gjithë zëmbërë  
te këjo jetë, e pra trazhqofshim  
me 'Të gjithëmonë te Parraisi?.*



3. Ndë lutur, shën Mëria  
rrij me Apostojit te shpia;  
Shpirti shejt i taksur erdhi,  
e mbi 'ta të mirat derdhi.

Zonja e lume e shën Mëri,  
bashkë me Tij u bënj haidhi.

*Jarshit Shejtia Frimë edhé  
mbi ne e na prufshit të mirat  
e dhuretët të 'tija shejte; thre-  
siëm dritën e 'Tij, kur zëm çedò  
e bëme te dita.*



4. Kur arruri dita e thënë,  
la e Bekuamia jetën t'ënë;  
te Parraisi in'Zot e ftoi ,  
me gjithë kurmin fluturoi.

Zonjë e lume e shën Mëri ,  
bashkë me Tij u bënë haidhi.

*Rrofshim nën shpagarit t'Më-  
mës Virgjërë e shë Mëri e me ndih-  
mën e 'Saj vdekshim tek e mira me  
t'ën'Zonë.*





5. Mbretëresha Ajo ndë kjiell  
throni i 'Saj shkëlqjen **di**  
diell  
isht hareja e Faremirit  
nuse , mëmë e bijë e t'Birit.

Zonjë e lume shën Mëri  
bashkë me 'Tij u bënj haidhì.

*Në Hir të t'in'Zoti duam të  
rim. Shën Mëris thomii nga di-  
të nusariin, se ngë do t'na li-  
pset kurr ndihma e 'Saj.*



Na Të falemi, o Perëndeshë , Mëmë-  
za e jonë gjith'lipisì, gjella, ëmbël-  
sia, shpresa e jonë. Na Të falemi.

Tij të thërresiëm na të shkretit  
bij të Evës.

Mbi Tij, o Mëme, pshërtojëm, tue rë-  
kuar e tue klar te këjo jetë e plo-  
të me lotë. Andai Ti, e shë Mbrizë,  
ndihma e jonë, prir mbi ne syt t'atë  
lipisì e , si sos këjò jetë e shkret-  
të , Ti dëftona pemën e gjirit t'ënt  
Isuthin. Se Ti je e butë, e ëmbël,  
gjith'lipisì, o Zonja Virgjërë e Shën  
Mëri. Ashtu' kloft.

P a r k a l e s i t'in' Zoti

Na t'biem përmist, i Madh'in'Zot,  
e të lutemi me gjithë zëmbërë.

Të truajëm fort Klishtë Shejte,  
çë Ti stise në jetë e Papën shejt,  
çë Ti vure në vend t'ënt.

Klisha jote katolike po kloft mundësore mbi gjithë të ligat e mbi gjithë errësiat edhe erezit.

Mos të klofshin kurr ndajtur bijtët t'atë, o i Madh'in'Zot, po kloft pakjësja e jote ndër gjithë kombet te jeta që Ti shpërbleve me gjakun t'ent akjë të shtrjt. U njomshin zëmbrat e të mëkatruamëvet e gjetshin tek Ti lipisì.

Të truajëm, o Zoti Krisht, gjinden t'ënë t'arbëreshe ku do ndodhen edhe janë. Ti jipi dritën te të njohiën hiet e bekimet sa të T'shërbejën, sa të len mirë. Të truajëm gjërìn t'ënë, mikjët, armikjët e gjithë njeri që na truhën te parkalesia.

Rrusarii shejt që jemi e thomi vafshit edhe për shpirtrat që janë te Purgatorii.

Sa të kemi Ndëjesat t'shejte parkalesiëm si do Klisha e shejte tue thënë: Ati i jinë ... Falem Mëri ...  
Lëvdì past ...



ΜΡ

ΘΥ

Η ΓΛΥΚΟ

ΦΙΛΥΣΑ

ΙC  
ΧC

L I T A N I A e shë Mëris

---

Kjërrie eléison

Hristé eléison

Kjërrie eléison

Gjëgjëna , o Zoti Krisht

Gjëgjëna , o Krisht,gjëgjëna

Ati i kjëllesiës in'Zot , lipisì për ne.

Bir,Shpërblés i dheut

in'Zot , ,

Shpirt i Shejt in'Zot , ,

*Shejte trimë në vetëm in'Zot*

E Shën Mëri , parkalés për ne.

Shejtia Mëmë e t'in'Zoti,

Shejtia Virgjër'e Virgjëravet,

Mëma e Krishtit ,

Mëma e t'hjynushmit Hir ,

Mëmë e dëlirë ,

Mëmë e ndershme ,

Mëmë e pangarë ,

Mëmë e paftesme ,

Mëmë e dashurë ,

Mëmë famasore ,

Mëma e këshillit i mirë ,  
Mëma e Stisorit ,  
Mëma e Shelbuesit ,  
Virgjërë e prënoreme ,  
Virgjërë e përfalurë  
Virgjërë e lëvduashme ,  
Virgjërë e pushtetshme ,  
Virgjërë e besme , *virgjëri lipisiane*  
Paskjira e Ligjës ,  
Throni i urtësis ,  
Kroi i harës t'ënë ,  
Puçer shpirtëror ,  
Puçer i prëndërm ,  
Puçer i ndritëm i të luturit ,  
Trundafille e mistike ,  
Pirgjë e Davidhit ,  
Pirgjë e eburtë , — ?  
Shpia e artë ,  
Arka e Dhiatës ,  
Dera e kjëlliës ,  
Ylli i menatës ,  
Shëndetia e të sëmurëvet ,  
Pështrimi i të mëkatruamëvet ,  
Gëzimi i të helmruamëvet ,

Ndihma e të kreshterëvet ,  
 Perëndesha e Ëngjëjvet ,  
 Perëndesha e Patriarkravet ,  
 Perëndesha e Profetravet ,  
 Perëndesha e Apostojvet ,  
 Perëndesha e Martravet ,  
 Perëndesha e Skomollerëvet ,  
 Perëndesha e Virgjëravet ,  
 Perëndeshë që zure pa e ngarë  
                                  nga faji i parë ,  
 Perëndesha e ngjipurë në kjiell ,  
 Perëndesha e Pakjies ,  
 Perëndesha e rrusariit shejt ,  
 Shë Mbëriza Odhijitrie ,                     (2)

p a r k a l e s p ë r n e .

Kjenkji i t'in'Zoti që mëkatët  
 e jetës ndsier , ndëjéna, o i Madhi  
 in'Zot .

Kjenkji i t'in'Zoti që mëkatët  
 e jetës ndsier , gjegjëna, o i Madhi  
 in'Zot,

Kjenkji i t'in'Zoti, që mëkatët  
 e jetës ndsier, lipisi për ne .

(1) Perëndesha e gjithë  
skriturave

(2) Qendësia e hipur në kjiell



I larti Perëndi, Biri i jiti i vetëmi jerdhi te jeta , duroi , vdi-  
kjë e pran u ngjall sa t'na shpër-  
blej gjellën e pasosme , si edhe  
kemi kujtuar te misteret e rrusari-  
it ; Ti , i Madh'in'Zot , po dhuro-  
na huret shejtë të mos lëm kurr  
dhromin e Krishtit t'bekuam e të  
kemi pra të taksurën gjellë te Par-  
raisi , ku do 'trazhgojëm gjithë  
monë.

O Zonja e Parraisit, na tek Ti vi-  
jëm e kuturisemi. Gjithë shpresën  
t'ënë e kemi tek Ti. Ti na ruan  
nën shpagarit t'ënt, o Mëmëza jonë.

U t'falem , Perëndeshë,  
çë je mëmëza e jonë,  
e çë sivàs t'ën'Zonë  
të vemi n'kjell.

Gaze e haré Ti siell,  
kuj ndodhet në hjidhà,  
e kuj me shpresë rri  
shpresë i dhuròn.

Të thërrét e të kërkon  
këjo zëmbërë e ngarrafosme  
çë ë gjith'e farmakosme  
e në skurì.

Zonja Virgjërë e shë Mbrì,  
me at'sy , çë t'llambaris  
gjith'jetën e lipis;  
Ti vurna're.

Priru e bën-na hje,  
me shpagërin t'ënt pështrona,  
e Birin t'ënt dëftona  
në jetë çë ngë sos .

Mos e mirr me kopos,  
Mëma Virgjërë e shën Mbrì,  
mirre me lipisì  
këtë këngëzë shejtë.

Ndëjena të mjerët shpejt  
në këtë t'errurë jetë  
tek ajo jetëzë e ftetë  
ëna Parraisin .

